



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 16.4/b dhe atij 33, të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullorës nr. 2003/30, të dt. 10. 09.2003; nenit 3, par.1, pika “b”, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, nenit 19, par.1, pika “b”, të Statutit dhe të rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001 dhe të nenit 9 të Vendimit për miratimin e Planit strategjik- zhvillimi urban i Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.03.2005 merr

V E N D I M

PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLATIV PËR LAGJEN “ULPIANA” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullativ për lagjen “Ulpiana” në Prishtinë.

Fillimi i hartimit të Planit, nga par.1 i këtij neni, bëhet me qëllim të harmonizimit të Planit të hollësishëm urbanistik ekzistues të asaj lagjeje, me Ligjin për planifikim hapësinor dhe Planin strategjik- zhvillimi urban i Prishtinës.

Neni 2

Hartimi i Planit, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të bëhet sipas fazave, varësisht nga pozita e hapësirës, në kuadër të kufijve të Planit urbanistik ekzistues, e të pa realizuara sipas atij Plani, si dhe nevojës për ndryshimin dhe plotësimin e tij.

Neni 3

Faza e parë e hartimit të Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi, përfshinë kompleksin “Qendra-Ulpiana” në Prishtinë.

Kompleksi , nga parag. 1 i këtij neni, përfshinë hapësirën në mes të rrugëve “Bulevardi i Dëshmorëve” dhe “Imzot Nikë Prela”.

Hapësira, nga par.2 i këtij neni, përfshinë ngastrat kadastrale nr. 2779/1, 2779/2, 2779/3, 2774/3, 2774/1, 2778/9, 2778/10, 2778/5, 2778/6, 2778/3, 2778/4, 2778/7, 2778/11, 2780/1, 2780/2, 2781/1, si dhe pjesët e ngastrave nr. 7435, 2782/2, 2778/1, 2778/2, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4.65.35 ha.

Neni 4

Fazat tjera të hartimit të Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi, do të bëhen sipas prioriteteve dhe detyrave programore të Drejtoratit të Planifikimit, të Urbanizmit dhe të Ndërtimit të Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Secila fazë e hartimit të Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me Vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, sipas procedurave të parapara me Ligjin për planifikimin hapësinor.

Neni 6

Bartës i detyrave projektuese për hartimin e Planit rregullativ, sipas këtij Vendimi, është Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Hartimi i Planit rregullativ, sipas fazave përkatëse, do të bëhet përmes shpalljes së ofertave.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.
Për realizimin e këtij Vendimi, secili organ ekzekutiv i Komunës së Prishtinës do të kryejë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara me ligj.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.031-7330 dt. 05.04.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri